

STATUTI I **SENATIT**

SENA POLIS
Qeveria studentore

Hyrje

Në Universitetin POLIS studentët organizohen në Përfaqësinë e Studentëve, që është një organizim i pavarur, që nuk zhvillon aktivitete politike dhe ekonomike.

Përfaqësia e Studentëve ose Senati Studentor (Sena-Polis) është një organizim i pavarur, që ka për detyrë të promovojë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucionit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.

Përfaqësia e Studentëve shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të Universitetit POLIS, si për planet e programet e studimeve, rregulloren dhe veprimtaritë mësimore, cilësinë e shërbimeve, të drejtën për të studiuar, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturor, artistike, sportive.

Përfaqësia Studentore ka për detyrë të përfaqësojë pa rezerva çdo mendim apo kërkesë individuale të studentëve të Universitetit në përputhje me ligjet dhe rregullat e Universitetit. Përfaqësia Studentore nuk ka të drejtë të organizohet në struktura të tjera politike e jopolitike jashtë Universitetit POLIS.

Senati Studentor ka stemën e tij e cila është e pandryshueshme.

Askush brënda apo jashtë shkollës nuk mund të ndërhyjë në punët e Senatit Studentor sepse ky i fundit është mishërimi i të gjitha vlerave të studentëve dhe të Universitetit të cilat janë të shenjta dhe të patjetërueshme.

Sovraniteti i vendim-marrjes së Senatit Studentor është i pacenueshëm.



Skema organizative

Përfaqësia Studentore përbëhet nga këta përfaqësues:

- Presidenti i Senatit (përfaqësues i studentëve në Senatin e Universitetit)
- Senatorët (përfaqësues të çdo viti akademik)
- Sekretari Organizativ
- Përfaqësuesi në Qendrën e Cilësisë të Universitetit për Garantimin e Cilësisë



Përfaqësia Studentore

Zgjedhjet e Senatorëve

- I. Secili kurs studimi në cdo profil studimi përfaqësohet nga një senator i vetëm.
- II. Zgjedhjet do të zhvillohen në fund të javës së tretë nga fillimi i vitit akademik.
- III. Zgjedhjet do të organizohen nga senatorët e vitit paraardhës me ndihmën e Administratës së Universitetit.
- IV. Çdo student ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet si përfaqësues i kursit të tij.
- V. Votimi është i fshehtë dhe do kryhet në orar të përshtatshëm në respekt të orarit mësimor.
- VI. Senatori zgjidhet me shumicë votash.
- VII. Kandidatët duhet të paraqiten me kërkesë deri në fund të javës së dytë mësimore nga fillimi i vitit akademik.
- VIII. Lejohen propaganda dhe fushatat zgjedhore në favorin e kandidatëve.
- IX. Që nga momenti i konstituimit zyrtar të Senatit Studentor në mbledhjen e tij të parë të drejtat dhe detyrat e senatorit hyjnë në fuqi.
- X. Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tyre përcaktohen në Rregulloret e Brendshme, të cilat hartohen në përputhje me kërkesat e statutit dhe propozimeve të studentëve.

Përfaqësia Studentore

Presidenti i Senatit Studentor

- I. Presidenti zgjidhet në mbledhjen e parë ceremoniale të Senatit të thirrur nga Përfaqësia paraardhëse dhe Përfaqësia e re Studentore.
- II. Zgjedhja bëhet me votim nga senatorët e rinj të zgjedhur.
- III. Votimi për president bëhet pasi është realizuar më parë ceremonia për konstituimin zyrtar të Përfaqësisë së re Studentore, dhe nënshkrimit të Kartës së Parimeve (ose Rregullores) të Universitetit (Consortiumit).
- IV. Çdo senator ka të drejtën e kandidimit për postin e Presidentit të Senatit, dhe për këtë ai ka të drejtën të shpallë kandidaturën dhe të shprehet në mbledhjen e konstituimit të Senatit të ri Studentor me një prezantim 5 minuta mbi objektivat e tij si President.
- V. Presidenti është personi më i rëndësishëm në hierarkinë e Përfaqësisë së studentëve.
- VI. Ka për detyrë të përfaqësojë të drejtat dhe mendimet e çdo studenti si dhe të informojë Rektoratin dhe Administratorin në lidhje me to.
- VII. Është përgjegjës që të garantojë në fillim të mandatit hartimin e një plani pune, me objektivat dhe buxhetin përkatës, të cilat ua bën të njohura senatorëve, dhe nga të cilët merr miratim përmes shumicës së votave në mbledhjen më të afërt të Senatit Studentor.
- VIII. Është organizatori dhe përgjegjësi kryesor i punës së Senatit si dhe mban përgjegjësi direkte në përfaqësimin e Senatit në Universitet apo jashtë saj dhe në rrjetet e partnerëve brenda dhe jashtë vendit.
- IX. Udhëzon Sekretarin Organizativ për mbledhjet e Senatit, mbajtjen e protokollit dhe të financave si dhe ka për detyrë t'i drejtojë ato.
- X. Mund t'i kthejë mbrapsht vendimet e Senatit apo senatorëve kur pas konsultimit me juristin e Universitetit konstaton se ato bien ndesh me Statutin e Senatit Studentor, Rregulloren e Brendshme të Universitetit si dhe me objektivat e shpallura që në fillim të vitit.
- XI. Cakton grupet e përkohshme të punës si dhe u jep atyre udhëzime përkatëse sipas rastit.

- XII. Mund të inicioje në Senatin Studentor procedurat për shkarkimin e senatorëve në rast se qëndrimet e tyre bien ndesh me Statutin e Senatit si dhe për paaftësi të përfaqësimit të kursit të tyre.
- XIII. Është i detyruar të bëjë publik cdo vendim apo iniciativë të tijën si ne rastet kur i kërkohet nga Rektorati ashtu dhe nga senatorët apo studentët.
- XIV. Mund të shkarkohet në raste të jashtëzakonshme pas një vendimi të shumicës absolute të senatorëve dhe sipas procedurave demokratike ku cdo anëtar i senatit ka të drejtë të shprehë qëndrimin e tij dhe të votojë.
- XV. Ka të drejtë dhe detyrë të marri pjesë dhe të përfaqësojë studentët në mbledhjet e Senatit Akademik të Universitetit.

Përfaqësia Studentore

Sekretari Organizativ

- I. Sekretari Organizativ i Senatit zgjidhet me shumicë të votave nga Përfaqësia e Studentëve me propozim të Presidentit të Senatit.
- II. Zgjedhja e tij bëhet në mbledhjen e parë të konstituimit të Senatit Studentor, pas procedurave të zgjedhjes së Presidentit.
- III. Është personi i dytë më i rëndësishëm në hierarkinë e Përfaqësisë Studentore dhe detyrat e tij janë të përkohshme dhe të ndryshueshme.
- IV. Është simboli i unitetit të Senatit të Universitetit si dhe imazhi i këtij të fundit në marrëdhëniet me jashtë.
- V. Në marrëdhëniet me jashtë mban përgjegjësinë kryesore të përfaqësimit si dhe ka për detyrë të informojë Senatin Studentor dhe Akadamik të Universitetit për rolin dhe kontributin e tij në këtë përfaqësim.
- VI. Sekretari me udhëzimet e marra nga Presidenti i Senatit Studentor ka për detyrë të thërrasë si dhe të organizojë mbledhjet e Senatit.
- VII. Është përgjegjës për gjetjen e ambjenteve dhe plotësimin e senatorëve me baza materiale, mbajtjen e protokollit dhe dokumentacionit dhe të arkës së financave.
- VIII. Thërret dhe drejton mbledhjet e senatit në rast se posti i presidentit është vakant, përfshi organizimin e mbledhjes për konstituimin e Senatit të ri Studentor.
- IX. Mandati i tij mbaron në momentin e Konstituimit të Senatit të ri Studentor.
- X. Mund të shkarkohet me një procedure dhe vendim të Presidentit të Senatit Studentor i cili diskutohet nga Senati Studentor dhe votohet nga shumica e anëtarëve të tij, në rastet ku demonstroi paaftësi dhe indiferencë në menaxhimin e detyrave që i cakton ky statut.
- XI. Detyrat e tij të përkohshme caktohen nga Presidenti i Senatit dhe ato janë të ndryshueshme sipas rastit.
- XII. Merret me procesverbalet e çdo mbledhjeje dhe me arkivimin e tyre.
- XIII. Administron financat dhe kontributet, dhe raporton për to. Është përgjegjës për buxhetin dhe raportin financiar. Rakordon me

Administratorin, Rektoratin dhe Financierin e universitetit për financimet që jepen nga universiteti. Ndërsa për kontributet e studentëve dhe projekteve e donatorëve potenciale, koordinon me palët e interesuara.

Përfaqësia Studentore

Senatori

- I. Zgjidhet në fillim të vitit mësimor mbasi ka arritur shumicën gjatë votimit të fshehtë brenda komunitetit studentor të kursit të tij.
- II. Është, përfaqesues i **vitit** kursit perkates dhe ka të drejtën e vendimarrjes vetëm për problemet dhe punët e ndryshme brenda kursit përkatës.
- III. Vendimet qe ai merr brenda kursit janë në mbështetje të interesave të shumicës së studentëve, por në asnjë rast nuk mund të injorojë kërkesat dhe problemet e cdo studenti.
- IV. Përfaqëson kursin në Përfaqësinë e Studentëve të shkollës
- V. Nuk mund të mungojë me shume se dy mbledhje të njëpasnjëshme të Senatit Studentor. Në këtë rast Presidenti i Senatit inicion procedurat për shkarkim me motivacionin për paaftësi në përfaqësimin e kursit përkatës në Përfaqësinë Studentore.
- VI. Është i detyruar të verifikojë çdo veprim të tijin nëse është në përputhje me këtë Statut dhe me objektivat e Senatit të cilat shpallen nga presidenti i Senatit qysh në fillimin e aktivitetit të tij.
- VII. Çdo senator ka të drejtë të kandidojë në zgjedhjet për postin e Presidentit të Senatit dhe te Sekretarit Organizativ nëqoftese zgjedhja e tij nuk bie në kundërshtim me asnjërën nga pikat e këtij Senati.
- VIII. Mund të caktohet nga Presidenti i Senatit si anëtar i “Grupeve të perkohshme të punës”.
- IX. Është i detyruar të përfaqësojë dhe të mbrojë veprimtarinë e Senatit tek studentët e tij si dhe nuk mund të shpërfillë udhrat dhe vendimet e Presidentit të Senatit.
- X. Senatori nuk mund të ndërmarrë iniciativa vetjake pa u konsultuar me Qeverinë Studentore dhe pa marrë miratimin e tyre.

Përfaqësia Studentore

Votimi brenda Senatit

- I. Për çështjet dhe problemet e zakonshme që mund të lindin gjatë Senatit Studentor vendimi merret me mirëkuptim ose kur është nevojshme me arritjen e shumicës mbas votimit të hapur.
- II. Për çështjet e rëndësishme, vendimi merret mbas votimit me shumicë votash.

Mbledhjet e Senatit

- I. Zhvillohen një herë në dy javë, por jo më pak se një herë në muaj, të thirrura nga Sekretari Organizativ, nën drejtimin e Presidentit të Senatit ose Sekretarit Organizativ në rastet e parashikuara nga ky Statut.
- II. Programi i çështjeve që do të trajtohen në mbledhjen e Senatit Studentor bëhet publik në vendin e lajmërimeve të Universitetit ose me e-mail.
- III. Veprimtaria e mbledhjes pasqyrohet në Librin e Senatit (Protokoll) dhe kërkesat e problemet që dalin gjatë mbledhjes i njoftohen Rektoratit dhe Administratorit, grupeve të përkohshme të punës, si dhe studentëve përmes njoftimit elektronik dhe zyrtar.

Grupet e përkohshme të punës

- I. Caktohen nga Presidenti i Senatit për zgjidhjen e çështjeve të veçanta, që kanë të bëjnë me aktivitetin e Senatit.
- II. Anëtarët e grupeve mund të jenë senatorë dhe studente të universitetit, si dhe ekspertë-specialistë nga stafi i Universitetit ose jashtë saj.
- III. Grupet shpërblehen pasi kanë përfunduar detyrën që u caktohet nga Presidenti i Senatit ose Senati, dhe kostot financiare bëhen transparente në raportin vjetor të

Senatit Studentor që u shpëndalet studentëve, pedagogëve, Rektoratit dhe Administratorit.

Statuti i Senatit

- I. Çdo senator duhet t'i përmbahet këtij statuti.
- II. Statuti është i përhershëm, por me unanimitet votash të Senatit Studentor mund të shtohet, hiqet ose modifikohet ndonjë nen i tij.
- III. Statuti i miratuar i Senatit Studentor i dergohet zyrtarisht Rektoratit dhe Administratorit të Universitetit dhe verifikohet në mbledhjen e Senatit Akademik në se është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e brendshme rregulluese të Universitetit, si Statuti, Rregullorja, etj.

“Me bindjen se edukimi i mirë është aspiratë themelore e çdonjërit prej nesh, me besimin se një ditë ne që sot jemi student do të jemi elita e këtij vendi, me zotimin për mbrojtjen e të drejtave të studentëve dhe me frymen e tolerancës dhe mirekuptimit:

VENDOSIM KËTË STATUT

Themeluan:

Anëtarët e Senatit Studentor:

ERMIR NASI



Felissia Velup



Florid Virejoni



Miratuan :

Presidenti i Senatit Studentor

Glodion Douhi




Përfaqësuesi i Senatit Akademik

